



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 64

Prishtinë, më 23.5.12.2016, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Selvije Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Agim Ademaj, Armend Zemaj dhe Milena Miliqeviç.

**Munguan:** Doruntinë Maloku, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, dhe Valdete Bajrami.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Dibran Istrefi, Klan Kosova; Mirlinda Dreshaj-Berisha, NJIFK; Dren Ajeti, GLSP; Sanije Bersisha, OSBE; Amire Qamili, BIRN; Norë Shabani, “Koha ditore”; Shahadije Bikliqi, Kohavision; Dredhëza Ahmetxhekaj, Rrokum Tv; Aida Dobrunaj, praktikante; Egon Pacolli, praktikant; Mërgime Kajtazi.

**Mbledhjen e kryesoi,** Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
3. Të ndryshme.

**Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit**

**Kryesuesja** hapi mbledhjen dhe ftoi anëtarët e Komisionit, që të marrin fjalën lidhur me Raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional në Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

**Armend Zemaj**, në fjalën e tij, tha se ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, sepse lufton dukuritë negative, sidomos parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Sido që të jetë, ky projektligj përfshin mbrojtjen e interesave të përgjithshme të vendit, por mbi të gjitha, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe ndalimin e qarkullimit të instrumenteve monetare, brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë të paligjshme, dhe si i tillë, duhet të miratohet. Deputeti Zemaj kishte vërejtje në nenin 56, paragrafi 3.3. Sipas tij, ky nen është i panevojshëm, sepse bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për gjykatat, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Ndërsa, sa i përket pjesës, të ndëshkimit, janë në harmoni të plotë me ligjet tjera bazike, prandaj Komisioni Funkcional duhet t'u japë përkrahje këtyre amendamenteve dhe ligjit në tërësi, potencoi deputeti Armend Zemaj.

**Kryesuesja**, në fjalën e saj, sqaroi se Komisioni Funkcional nuk ka kërkuar që të diskutohet neni 56 dhe paragrafi 3.3. Më tej, deputetja Halimi lexoi paragrafin 3.3 të projektligjit, në mënyrë që kjo dilemë të qartësohet. Ky nen nuk bie ndesh me dispozitat e Kodit Penal, dhe si i tillë, duhet të mbetet në projektligj, përveç në pjesën ku thuhet se gjykatat e Kosovës “mund të kenë” dhe propozoi që fjala “mund”, të zëvendësohet me fjalën “duhet”.

*Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë:*

### **REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. I rekomandohet Komisionit Funkcional, që në nenin 56, paragrafi 3.3 të projektligjit, fjala “mund”, të zëvendësohet me fjalën “duhet”.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.  
Mirlinda Kolgeci

Nënkryetarja e Komisionit,  

---

**Selvije Halimi**